



## farë mund të bëjë për ju Kind en Gezin?

Mund të **keni besim te mbështetja dhe këshillat tona që prej momentit që vendosni të bëheni me fëmijë, gjatë shtatzënisë dhe në vitet e para të rëndësishme të jetës së fëmijës tuaj (nga 0 në 3 vjeç)**. Mund të na drejtoheni me **çdo pyetje apo shqetësim**.

Familja dhe fëmija juaj janë fokusi ynë.

do ekip lokal i Kind en Gezin përbëhet nga profesionistë (infirmierë, mjekë, punonjës për mbështetjen familjare, punonjës social dhe psikopedagogë) me ekspertiza të ndryshme për t`ju mbështetur maksimalisht në **të gjithë aspektet e prindërimit**.

Ne ofrojmë gatishmëri për t`ju dëgjuar dhe mbështetje të bazuar në evidenca mbi:



Shtatzëninë



Prindërimin dhe rritjen e fëmijës



Shëndetin dhe vaksinimin



Zhvillimin, rritjen, të ushqyerin dhe sigurinë



Kujdesin për fëmijë



## Kur mund t`i drejtoheni Kind en Gezin?

- Ne duam t`ju njohim qysh në shtatzëni.
- Do t`ju bëjmë një vizitë në shtëpi menjëherë pas lindjes.
- Do t`ju ftojme në orare të caktuara për kontrollet dhe vaksinimet e fëmijës tuaj. Po ashtu, do kryejmë edhe një test për dëgjimin dhe shikimin. Mund të vizitoni qendrën tuaj vendore të shëndetit për këtë gjë.
- Dëshironi një diskutim më të thellë? Kërkoni një vizitë shtesë në shtëpi, një konsultim për prindërimin dhe rritjen e fëmijës (spreekuur ouderschap en opvoeding) ose një kontakt shtesë (digjital) ... për këshillë të personalizuar.

### Shërbimet e Kind en Gezin's janë falas.



Mund të gjeni më shumë informacion në faqen <https://www.kindengezin.be/en/child-and-family>.



Zbuloni informacion të përkthyer mbi tematikat tona në faqen tonë të internetit.



## A keni pyetje?

Kontakttoni linjën për ndihmë të Kind en Gezin:



Telefononi numrin 078 150 100 nga e hëna në të premte midis orës 08.00 të mëngjesit dhe orës 08.00 të mbrëmjes.



Bisedoni ose dërgoni email përmes faqes tonë me një infermier nga e hëna në të premte midis orës 09.00 të mëngjesit dhe orës 04.30 pasdite.

